

DEKLARATE E PERBASHKET

e kooperimit midis Ministrise se Drejtesise se Rumanise dhe Ministrise se Drejtesise se Shqiperise

Ministria e Drejtesise se Rumanise dhe Ministria e Drejtesise se Shqiperise,

te bindura per dobine e stabilizimit te marredhenieve ne fushen e kompetences se tyre,

te bindura qe kooperimi midis Rumanise dhe Shqiperise ne fushen e drejtesise dhe administrimit te drejtesise luan nje rol te rendesishem ne konsolidimin e marredhenieve midis dy vendeve,


kane vendosur :

1. Te dy ministrite do te koeporojne ne fushen e legjislacionit, formimit te magjistrateve dhe personelit ndihmes te administrates se drejtesise, perdorimit te teknikave te kalkulimit ne praktiken juridike si edhe ne fushen e administrates penitenciare. Per kete qellim:
 - a) do te vene ne dispozicion me kerkesen e njeres pale ose inisiativen e vet, tekste legjislative, literature dhe publikime te fushes se kompetences se tyre;
 - b) do te informojne reciprokisht per ndryshimet ne organizimin e drejtesise;
 - c) do te permiresojne format e asistences juridike dhe te bashkepunimit te marredhenieve bilaterale;
 - d) do te stabilizojne forma te kooperimit ne aktivitetin e formimit te magjistrateve dhe te personelit ndihmes te drejtesise;
 - e) do te bejne shkembime informacioni dhe ekperience per sa i perket zbatimit te marreveshjeve evropiane te fushes te se drejtes penale.
2. Te dy ministrite do te nisin shkembime informacioni dhe eksperience ne fushen e harmonizimit te legjislacionit kombetar me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

3. Te dy ministrite do te koordinojne perpjekjet ne luften kunder krimin te organizuar, perfshi ketu edhe luften kunder veprave penale ekonomike dhe financiare, me qellim forcimin e kooperimit midis organeve te drejtesise.
4. Ne kuadrin e kompetencave te tyre, te dy ministrite do te çojne perpara kooperimin dhe ne fusha te tjera, te cilat nuk jane permendur ne kete deklarate.


E mbajtur ne Bukuresht me 11 Tetor 1999, ne dy ekzemplare origjinale, njeri ne gjuhen rumune dhe tjetri ne gjuhen shqipe, te dyja tekset kane te njejten vlere.

Ministri i Drejtesise
se Rumanise



Valeriu STOICA

Ministri i Drejtesise
se Shqiperise



Ilir PANDA